



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E SEKRETARIT TË KZAZ NR. 39, ANËTARIT TË KZAZ NR.85,
ANËTARIN KRYESISHT TË KZAZ NR.15, SEKRETARIN KRYESISHT TË KZAZ NR.36, PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 22.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirim dhe emërimin e sekretarit të kzaz nr. 39, anëtarit të kzaz nr.85, anëtarin kryesisht të kzaz nr.15, sekretarin kryesisht të kzaz nr.36, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, me shkresën nr. 11960, datë 20.06.2019, ka kërkuar:

- lirim të sekretarit të KZAZ nr. 39, z. Armando Loga dhe emërim të zj. Joana Duro;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 85, z. Ermal Mahilaj dhe emërim të zj. Floreta Lutaj;

Propozimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ-ve janë në përputhje me kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor.

- Me shkresën nr. 11966 prot., datë 20.06.2019, anëtarja e KZAZ nr. 15, zj. Naile Hysa, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin 829, datë 10.06.2019 për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me vendbanim në Bashkinë Kurbin.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se:

Nr. 854 i Vendimit Data 22.06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e sekretarit të kzaz nr. 39, anëtarit të kzaz nr.85, anëtarin kryesisht të kzaz nr.15, sekretarin kryesisht të kzaz nr.36, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



- z. Erand Ndoja, shtetas me vendbanim në Bashkinë Kurbin,

ka paraqitur kërkesë për t'u emëruar kryesisht anëtar i KZAZ nr. 15, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor dhe i propozohet KQZ-së për ta emëruar.

- Me shkresën nr. 12118 prot., datë 22.06.2019, Sekretari i KZAZ nr. 36, z. Eldorad Kice, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin 846, datë 21.06.2019 për arsye objektive ka kërkuar dorëheqjen.

KQZ bazuar në nenin 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor, liron nga detyra sekretarin e emëruar kryesisht dhe plotëson vakancën duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 09.04.2019.

Për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, plotësojnë kushtet për emërimin në pozicionin e sekretarit kryesisht të KZAZ nr. 36, shtetasit:

1. Erald Haxhi Ismaili;
2. Adi Shpëtim Muja;
3. Ornela Përparim Hida;

KQZ, në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", përzgjedhi përmes procedurës së shortit për plotësimin e vakancës së krijuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra sekretarin e KZAZ nr. 39, z. Armando Loga, anëtarin e KZAZ nr. 85, z. Ermal Mahilaj, të lirojë anëtarin kryesisht të KZAZ nr. 15, zj. Naile Hysa dhe sekretarin kryesisht të KZAZ nr. 36, z. Eldorad Kice.
2. Të emërojë sekretaren e KZAZ nr. 39, zj. Joana Duro, anëtares e KZAZ nr. 85, zj. Floreta Lutaj, të emërojë anëtarin kryesisht e KZAZ nr. 15, z. Erand Ndoja dhe sekretarin kryesisht të KZAZ nr. 36, z. Adi Muja.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Nr. 854 i Vendimit Data 22.06.2019 e Vendimit Ora 12:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin e sekretarit të kزاز nr. 39, anëtarit të kزاز nr.85, anëtarin kryesisht të kزاز nr.15, sekretarin kryesisht të kزاز nr.36, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

